



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1161 / prot.  
1

Elbasan, më 14.05.2024

VENDIM

Nr. 30, datë 14.05.2024

PËR SHPALLJEN E APLIKIMEVE PËR ANËTARË NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE DHE NË KOMISIONIN E APELIMIT NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhrin e MAS nr.101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet publike të arsimit të lartë", nenin 37, pika 2 e Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Senati Akademik,

Vendosi:

1. Të shpallë hapjen e procesit të aplikimeve për anëtarë në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) dhe anëtarë në Komisionin e Apelimit (KA) në Univesitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
2. Të drejtën për të aplikuar në KIZ e kanë individët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) Janë personel akademik me kohë të plotë në Univesitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani";
  - b) Janë studentë në Univesitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
  - c) Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
3. Të drejtën për të aplikuar në KA e kanë individët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 vjet, me kohë të plotë;
  - b) Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
4. Afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve për aplikim për anëtar i KIZ dhe KA në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", do të jetë data 16.05.2024, ora 15.00.
5. Të interesuarit duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin e aplikimit sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.

"Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Univesitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Skender TOPI



## FLETË APLIKIMI

### PËR

## ANËTARË NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

### (KATEGORIA PERSONEL AKADEMIK)

Në zbatim, të nenin 6 pika 2 të Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.29, datë 28.03.2024 unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, personel akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të \_\_\_\_\_, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, paraqes aplikimin tim për të qenë anëtar i Komisionit Institucional të zgjedhjeve pranë Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Në zbatim të nenit 6 pika a,e, të Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr. 29, datë 28.03.2024 së deklaroj se nuk kandidoj për autoritet drejtues dhe as për anëtar në organet drejtuese të UE "Aleksandër Xhuvani" dhe përmbush kriteret e mëposhtme:

- a- Jam personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
- b- Nuk kam qenë asnjëherë i dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;

Bashkëlidhur dokumentacioni i mëposhtëm:

- a- Vërtetim punësimi në UE lëshuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
- b- Kopje e dokumentit të identifikimit.

**Aplikanti/ja**

---

Emër, Atësi Mbiemër Firmë

## FLETË APLIKIMI

### PËR

## ANËTARË TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

### (KATEGORIA STUDENT)

Në zbatim, të nenin 7 pika 2 të Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.29, datë 28.03.2024, si dhe Vendimit nr....., datë të Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, student me kohë të plotë në Fakultetin \_\_\_\_\_, të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", paraqes aplikimin tim për të qenë anëtar i Komisionit Instutucional të Zgjedhjeve, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Në zbatim të nenit 6 pika 1/a të Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.29, datë 28.03.2024 deklaroj se nuk kandidoj për anëtar në organet drejtuese të çdo niveli në UE "Aleksandër Xhuvani" dhe përmbush kriteret e mëposhtëme:

Bashkëlidhur dokumentacioni i mëposhtëm:

- a- Vërtetim që është student me kohë të plotë lëshuar nga Sekretaria e Fakultetit përkatës.
- b- Kopje e dokumentit të identifikimit

**Aplikanti/ja**

---

Emër. Atësia Mbiemër Firmë

## FLETË APLIKIMI

### PËR

### ANËTARË TË KOMISIONIT TË APELIMIT NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

Në zbatim, të nenin 37, pika 2 të Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.29, datë 28.03.2024 unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, personel akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të \_\_\_\_\_, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, paraqes aplikimin tim për të qenë anëtar i Komisionit të Apelimit pranë Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Në zbatim të nenit 37 pika 2 deklaroj se nuk kandidoj për autoritet drejtues dhe as për anëtar në organet drejtuese të çdo niveli, si dhe përmbush kriteret e mëposhtëme;

- a- Kam përvojë pune në mësimdhënie, mbi 5 vjet, me kohë të plotë
- b- Nuk kam qenë asnjëherë i dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;

Bashkëlidhur dokumentacioni i mëposhtëm:

- a- Vërtetim punësimi në UE;
- b- Kopje e dokumentit të identifikimit

**Aplikanti/ja**

---

Emër, Atësia Mbiemër Firmë

## FORMULAR VETËDEKLARIMI

( Nuk jam i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë)

Në mbështetje të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, miratuar me Vendim nr.29, datë 28.03.2024 të Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” unë \_\_\_\_\_, kandidat për \_\_\_\_\_, (emër. atësi mbiemër)

deklaroj nën përgjegjësinë time se nuk jam i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;

Emër Mbiemër

Elbasan, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_